



UNIVERSITETI I ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"



NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr. 2764 Prot.
Elbasan, më 31/10 / 2019

Nr. 661 Prot.
Elbasan, më 5/11 / 2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE

PROFESIONALE NË

INSTITUCIONE

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI", përfaqësuar nga
Rektori i Universitetit, Prof. Dr. Skënder Topi**

Dhe

**NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR, përfaqësuar nga Drejtori, Z.
Hekuran Bezati**

Me synimin e sigurimit të cilësisë nga profesionistët e ardhshëm, performancës së lartë në profesion përvetësimin e mëtejshëm të njohurive teoriko-profesionale, të aftësive e shprehive praktike dhe normave të etikës e të sjelljes, zhvillimin e kapaciteteve të profesionistëve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, me qëllim realizimin me efikasitet të praktikave mësimore të studentëve që ndjekin studimet pranë Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje sipas dispozitave më poshtë:

NENI 1 Baza ligjore

Kjo marrëveshje lidhet në mbështetje të Ligjit 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe Ligjit Nr.10 137, dt. 11/05/2009 "Për Shëndetin Publik".

NENI 2 Objekti i marrëveshjes

Palët, bien dakord të bashkëpunojnë në mënyrë që studentët e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të zhvillojnë praktikat mësimore pranë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Elbasan.

NENI 3 Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ndihma që Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Elbasan do t'i japë Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në kryerjen me efikasitet të praktikave profesionale të studentëve që ndjekin studimet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

NENI 4

Përgjegjësitë e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Për zhvillimin e praktikës mësimore, Fakultetet e Universitetit kanë këto përgjegjësi:

1. miratojnë programet e praktikës profesionale.
2. hartojnë listën e praktikantëve që do të kryejnë praktikën profesionale.
3. caktojnë një koordinator përgjegjës për zhvillimin e praktikave profesionale për çdo fushë.
4. hartojnë dhe sigurojnë zbatimin e grafikut kohor të zhvillimit të praktikave profesionale.
5. i njoftojnë grafikun dhe listën e praktikantëve Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Elbasan, ku do të zhvillohet praktika profesionale.
6. monitorojnë zhvillimin me efikasitet të praktikës profesionale.

NENI 5

Përgjegjësitë e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Elbasan

Për zhvillimin e praktikës mësimore, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Elbasan ka këto përgjegjësi:

1. njofton strukturat që janë varësi e saj lidhur me këtë marrëveshje.
2. udhëzon personelin e strukturave të varësisë për lejimin dhe ndjekjen e praktikave profesionale në mjediset e tyre.
3. krijon mundësinë e ofrimit të asistencës profesionale për studentët praktikantë gjatë zhvillimit të praktikës mësimore duke vënë në dispozicion specialistët e fushës të angazhuar në strukturat e varësisë së saj.
4. krijon kushte fizike për zhvillimin e praktikës profesionale.

NENI 6

Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme për vitin akademik 2019-2020, me të drejtë të përsëritjes së saj çdo vit.

NENI 7

Kjo marrëveshje do të përfundojë:

1. Me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 6 të saj.
2. Kur objekti nuk përdoret sipas qëllimit të përcaktuar në marrëveshje.

Pasi u lexua, marrëveshja nënshkruhet me vullnet të lirë e të plotë nga të dy palët.
Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, nga një për secilën palë, e cila firmoset e vulloset nga secila prej palëve.

**PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT
"ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI**

Prof.Dr.Skender TOPI



**PËR NJËSINË VENDORE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR
ELBASAN
DREJTORI**

Z. Hekuran BEZATI

